

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVA KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ		
DREJTORIA E ADMINISTRATËS DHE PERSONELIT • UPRAVA ADMINISTRACIJE I OSOBLJA		
Dalese / Izlaze: Date / Dana: 27.12.2023		
Nr. Orgv Org. jed. 01	Nr. Prot. Br. Prot. 123	Nr. Faqeve. Br. Strana. 1
Ferizaj - Uroševac		



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

KUVENDI I KOMUNËS
SKUPSTINA OPŠTINE
MUNICIPAL ASSEMBLY

01.Nr.123
Data: 22.12.2023

Bazuar në dispozitat e nenit 12, paragrafi 12.2, pika d neni 40 paragrafi 40.2 pika d i Ligjit Nr.03/L-040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta Zyrtëtare e Republikës së Kosovës"), Nr. 28/15, Qershor 2008) dispozitat e nenit 25, paragrafi 2 pika 2.4 dhe neni 34 i Statutit të Komunës së Ferizajt, 01.Nr.50 të datës 28.06.2013 dhe grupit punues për Hartimin e Planit Vjetor të Punës së Kuvendit të Komunës për Vitin 2024, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 22.12.2023 mori këtë:

VENDIM
PËR MIRATIMIN E PLANIT VJETOR TË PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS SË
FERIZAJT PËR VITIN 2024

I

MIRATOHET: Plani Vjetor i Punës së Kuvendit të Komunës së Ferizajt për Vitin 2024

II

Plani vjetorë i cekur në pikën I të këtij vendimi përmban: numrin e mbledhjeve, muajin në të cilin do të mbahen mbledhjet, muajin në të cilin do të mbahen mbledhjet e KK-së dhe pikat temat orjentuese që do të shqyrtohen nga ana e Kuvendit të Komunës.

III

Plani Vjetorë i Punës së Kuvendit të Komunës me përmbajtjen e cekur në nenin II të këtij vendimi është pjesa tabelare shtojcë e këtij vendimi.

IV

Për realizimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Ferizajt.

V

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në veb faqen e komunës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Xhavit Zariqi



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO		
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ		
DREJTORIA E ADMINISTRATËS DHE PERSONELIT • UPRAVA ADMINISTRACIJE I OSOBLJA		
Udhëse / Izlazne Date / Dana: 27.12.2023		
Nr. Orgv Org. jed. 01	Nr. Prot. Br. Prot. 124	Nr. Faqeve. Br. Strana. 1
Ferizaj - Uroševac		



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

KUVENDI I KOMUNËS
SKUPSTINA OPŠTINE
MUNICIPAL ASSEMBLY

01.Nr. 124
Data: 22.12.2023

Në bazë të nenit 12 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta Zyrtare Republikës së Kosovës, Nr.28/15, Qershor 2008/), të nenit 51 paragrafi 2 pika 9 e Statutit të Komunës së Ferizajt 01.Nr.50 të datës 28.06.2013, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 22.12.2023 miratoi këtë:

VENDIM

PËR APROVIMIN E STRATEGJISË SË ZHVILLIMIT EKONOMIK LOKAL PËR KOMUNËN E FERIZAJT PËR PERIUDHËN 2024-2034

I

Me këtë vendim miratohet Strategjia e Zhvillimit Ekonomik Lokal për Komunën e Ferizajt për periudhën 2024-2034.

II

Kjo Strategji e Zhvillimit Ekonomik Lokal të Komunës së Ferizajt paraqet një dokument të përpiluar kryesisht mbi bazën e Draft-Strategjisë për Vitin 2024-2034, ku pjesë përbërse e këtij vendimi është Strategjia e Zhvillimit Ekonomik Lokal për Komunën e Ferizajt për periudhën kohore 2024-2034.


III

Për realizimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës si dhe Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit.

IV

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në veb faqen e Komunës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës



Xhayit Zariqi

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVA KOMUNA E FERIZAJT - OPŠTINA UROŠEVAC - MUNICIPALITY OF FERIZAJ		
DREJTORIA E ADMINISTRATËS DHE PERSONELIT - UPRAVA ADMINISTRACIJE I OSOBLJA		
Dialese / Izlazne Date / Dana: 27.12.2023		
Nr. Orgv Org. jed: 01	Nr. Prot. Br. Prot.: 125	Nr. Faqeve. Br. Strana: 1
Ferizaj - Uroševac		



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO
 KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

KUVENDI I KOMUNËS
 SKUPSTINA OPŠTINE
 MUNICIPAL ASSEMBLY

01.Nr.125
 Data: 22.12.2023

Në bazë të nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Neni 352 Afati i përgjithshëm i parashkrimit, kërkesat parashkruhen për (5) vite, në qoftë se me ligj nuk është përcaktuar ndonjë afat tjetër i parashkrimit, Ligji Nr.04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, neni 10 paragrafi 10.2 të Ligjit Nr.03/L-49 për Financat e Pushtetit Lokal dhe neni 51 pika 2.9 të Statutit të Komunës Ferizaj 01.Nr.50 të datës 28.06.2013, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 22.12.2023 miratoi këtë:

VENDIM

PËR FALJEN E OBLIGIMEVE TË PAPAGUARA PËR TAKSËN NË AKTIVITET (AFARISTE).

I

MIRATOHET: Propozimi i Kryetarit të Komunës me Nr: 586/23 i datës 14.12.2023 për Faljen e Obligimeve të papaguara për taksën në aktivitet (afariste).

II

Me këtë vendim bëhet shlyerja e borxhit të papaguar për taksën në aktivitet (afariste), për të gjithë tatimpaguesit e Komunës së Ferizajt nga data 01.01.2000 deri me 31.12.2018.

III

Borxhet që do të shlyhen nga evidenca e borxheve të papaguara nga datat: 01.01.2000-31.12.2018 janë gjithsejtë 1,113,324.64 euro. Parashkrimi nuk zbatohet në rastet kur: taksapaguesit kanë paguar vullnetarisht detyrimet e tyre deri më tani.

IV

Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Drejtoria e Financave e Komunës së Ferizajt.

V

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në veb faqen e Komunës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës



Xhavit Zariqi

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO		
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ		
DREJTORIA E ADMINISTRATËS DHE PERSONELIT • UPRAVA ADMINISTRACIJE I OSOBLJA		
Dalese / Izlazne. Date / Dana: 27/12/2023		
Nr. Orgv Org. jed. 01	Nr. Prot. Br. Prot. 126	Nr. Faqeve. Br. Strana. 1
Ferizaj - Uroševac		



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

KUVENDI I KOMUNËS
SKUPSTINA OPŠTINE
MUNICIPAL ASSEMBLY

01.Nr.126
Data: 22.12.2023

Në bazë të dispozitave të nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenit 51 pika 2.9 të Statutit të Komunës 01.Nr.50 të datës 28.06.2013, nenit 13 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 6 të Rregullores (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 22.12.2023 miratoi këtë:

VENDIM
PËR PUBLIKIMIN E LISTËS SË PRONAVE KOMUNALE PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM PËR VITIN 2024.

I

Me këtë vendim publikohet lista e pronave për dhënien në shfrytëzim për Vitin 2024.

II

Pronat e përshkruara në listë mund të ipen në shfrytëzim vetëm pas plotësimit të kushteve ligjore dhe planifikimit në bazë të Planit Zhvillimor Komunal dhe Hartës Zonale.

III

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është edhe lista e pronave të publikuara për Vitin 2024.

IV

Për zbatimin e këtij vendimi përkujdesen: Kryetari i Komunës Ferizaj, Drejtoria për Zhvillim Ekonomik dhe Turizëm.

V

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas rexhistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në veb faqen e komunës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVA		
KOMUNA E FERIZAJT - OPŠTINA UROŠEVAC - MUNICIPALITY OF FERIZAJ		
DREJTORIA E ADMINISTRATËS DHE PERSONELIT - UPRAVA ADMINISTRACIJE I OSOBLJA		
Lloji i Izlaze: Date / Dana 27.12.2023		
Nr. Orgv. Org. jed. 01	Nr. Prot. Br. Prot. 127	Nr. Faqeve. Br. Strana. 1
Ferizaj - Uroševac		



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

KUVENDI I KOMUNËS
SKUPSTINA OPŠTINE
MUNICIPAL ASSEMBLY

01.Nr.127
Data: 22.12.2023

Në bazë të dispozitave të nenit 12 të ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040), Nenit 51 pika 2.9 të Statutit të Komunës së Ferizajt 01.Nr.50 i datës 28.06.2013 Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 22.12.2023 miratoi këtë:

VENDIM
PËR MIRATIMIN E RREGULLORËS PËR ORGANIZIMIN DHE SHFRYTËZIMIN E
PARKINGJEVE PUBLIKE DHE PRIVATE NË TERRITORIN E KOMUNËS SË
FERIZAJT.

I

MIRATOHET: Propozimi i Kryetarit të Komunës Ferizaj me Nr.554/23 i datës 11.12.2023 për Miratimin e Rregullorës për Organizimin dhe Shfrytëzimin e Parkingjeve Publike dhe Private në Territorin e Komunës së Ferizajt.

II

Kjo rregullore ka për qëllim të përcaktimin e zonave të vend-parkimeve, kushteve për shfrytëzimin e vend-parkimeve, mënyrës së pagesës, çmimit, llojit të biletave për vend-parkime, mënyrës së shfrytëzimit të tyre dhe mbikëqyrjes për parkimin e veturave në territorin e Komunës së Ferizajt.

III

Pjesë përbërse e këtij vendimi është edhe Rregullorja për Miratimin e Rregullorës për Organizimin dhe Shfrytëzimin e Parkingjeve Publike dhe Private në Territorin e Komunës së Ferizajt.

IV

Për realizimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës, si dhe Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencave Ferizaj.

V

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në veb faqen e komunës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO		
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ		
- EKTORIA E ADMINISTRATIVES DHE PERSONELIT - UPRAVA ADMINISTRACIJE I OSOBLJA		
Ishirje / Izdathe / Date / Datum: 27.12.2023		
Nr. Urgj. / Br. Prot. / 01	Nr. Prot. / Br. Prot. / 128	Nr. Faqeve. / Br. Strana. / 1
Ferizaj - Uroševac		



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

KUVENDI I KOMUNËS
SKUPSTINA OPŠTINE
MUNICIPAL ASSEMBLY

01.Nr.128
Data: 22.12.2023

Në bazë të nenit 12 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Nenit 7,8,9 dhe 10 i Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.05/2020 për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme dhe komiteteve tjera në Komunë si dhe nenit 17 paragrafi 17.1 të Statutit të Komunës së Ferizajt, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 22.12.2023 miratoi këtë:

VENDIM

PËR PLOTËSIM NDRYSHIMIN E VENDIMIT ME NR: 01.NR.52 I DATËS 28.02.2022

I

Me këtë Vendim Plotësohet-Ndryshohet Vendimi i datës 28.02.2022 me Nr. protokoli 01.Nr.52 vetëm sa i përket anëtarëve nga Subjekti Polikë LVV në Komitetin për Politikë dhe Financa, ku në vend të:

Adanan Selmanit, emërohet Brahim Osmani dhe në vend të:
Yllkë Neziri Hyseni emërohet Shqipe Jashari.

II

Të gjitha pikat tjera të Vendimit me Nr. 01.Nr.52 i datës 28.02.2022 mbesin në fuqi.

III


Për realizimin e këtij vendimi do të kujdeset Kuvendi i Komunës Ferizaj.

IV

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në veb faqen e komunës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Xhavit Zariqi



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVA KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ		
DREJTORIA E ADMINISTRATËS DHE PERSONELIT • UPRAVA ADMINISTRACIJE I OSOBLJA		
Dalese / Izlaze. Date / Dana: 27.12.2023		
Nr. Orgv Org. jed: 01	Nr. Prot. Br. Prot.: 129	Nr. Faqeve. Br. Strana: 1
Ferizaj - Uroševac		



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

KUVENDI I KOMUNËS
SKUPSTINA OPŠTINE
MUNICIPAL ASSEMBLY

01.Nr.129
Data: 22.12.2023

Në bazë të nenit 12 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Nenit 7,8,9 dhe 10 i Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.05/2020 për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme dhe komiteteve tjera në Komunë si dhe nenit 17 paragrafi 17.1 të Statutit të Komunës së Ferizajt, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 22.12.2023 miratoi këtë:

VENDIM

PËR PLOTËSIM NDRYSHIMIN E VENDIMIT ME NR: 01.NR.53 I DATËS 28.02.2022

I

Me këtë Vendim Plotësohet-Ndryshohet Vendimi i datës 28.02.2022 me Nr.protokoli 01.Nr.53 vetëm sa i përket anëtarit nga Subjekti Polikë LVV në Komitetin për komunitete, ku në vend të:

Brahim Osmanit, emërohet Amir Rexhepi.

II

Të gjitha pikat tjera të Vendimit me Nr. 01.Nr.53 i datës 28.02.2022 mbesin në fuqi.

III

Për realizimin e këtij vendimi do të kujdeset Kuvendi i Komunës Ferizaj.

IV

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në veb faqen e komunës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës



Xhavit Zariqi